

VENDIM
Nr. 495, datë 20.6.2013

**PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE NË
FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, të shkronjës “ç” të nenit 4 të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 “Për shitblerjen e trojeve”, të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175, të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore sipas listës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për:

a) Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, 156 (njëqind e pesëdhjetë e gjashtë) parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 53 376 (pesëdhjetë e tre mijë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë) m²;

b) Drejtorinë e ALUIZNI-t Vlorë 1, 1 (një) parcelë ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 428 (katërqind e njëzet e tetë) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha